



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1316/7prot

Datë. 26.07.2022

V E N D I M
Nr. 716/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës. 26.07.2022, shqyrtoi çështjen me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “N.N.Z.K.Shkodra” SHPK dhe “LEKA -2007” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-30887-05-26-2022, me objekt: “*Blerje kontenierë për mbeturina*”, me fond limit 5.146.667 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 13.06.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Sarandë.
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Sarandë
Adresa: Rr. “Abedin Dino”, Lagjja Nr.1. Sarandë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Luar Bros” SHPK
Adresa: Rr. “Nasi Pavllo”, pall.15/1, Shkalla 1, Ap.1,Tiranë.
- Subjekte të Interesuar:** Operatori ekonomik “N.N.Z.K.Shkodra” SHPK.
Adresa: Lagjja Partizani, Rr: Lëvizja e Postribës, godinë Ikatëshe, Nr.52, Shkodër.
- Operatori ekonomik “LEKA -2007” SHPK.
Adresa: Lagjja Beslidhja, Rr:“Luigj Gurakuqi”, Zyre ne zonen kadastrale nr.8632, numri i pasurise 7/195-N17, Lezhë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për*

miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 02.06.2022 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-30887-05-26-2022, me objekt: “Blerje kontenierë për mbeturina”, me fond limit 5.146.667 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 13.06.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Sarandë.

II.2. Në datën 13.06.2022, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 15.06.2022 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si më poshtë:

- “LEKA-2007” SHPK	4.680.000	I kualifikuar
- “N.N.Z.K.Shkodra” SHPK	4.860.000	I kualifikuar
- “LUAR BROS” SHPK	5.095.200	I kualifikuar

II.4. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike rezulton, se autoriteti kontraktor më datë 16.06.2022 ka publikuar Njoftim-Fituesin për procedurën e prokurimit objektankimi.

II.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 20.06.2022 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr. 1316 e operatorit ekonomik “Luar Bros” SHPK me objekt shfuqizim të vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “N.N.Z.K.Shkodra” SHPK dhe “LEKA -2007” SHPK.

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik publikoi në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si edhe formularin e publikimit me nr. 1316/2 datë 20.06.2022 referuar kritereve të cilat operatori ekonomik ankimues “Luar Bros” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurë “N.N.Z.K.Shkodra” SHPK dhe “LEKA-2007” SHPK.

II.7. Në përfundim të afatit 5 ditor brenda të cilit autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor të trajtimit të ankesës dhe daljes me një vendim përfundimtar në lidhje me të, Komisioni i Prokurimit Publik me anë të shkresës nr. 1316/3 prot., datë 29.06.2022, i ka kërkuar autoritetit kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik ankimues si dhe vendimin e autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Luar Bros” SHPK.

II.8. Me shkresën nr. 2757/1 prot, datë 30.06.2022, protokolluar me tonën me nr. 1316/5 prot datë 07.07.2022 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, kthim përgjigje e autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Luar Bros” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur pranimi pjesërisht i ankesës.

Gjithashtu, nëpërmjet shkresës nr. 2960/1 prot., datë 05.07.2022 protokolluar me tonën me nr. 1316/4 prot., datë 07.07.2022 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor në lidhje me procedurën e prokurimit.

II.9. Referuar shkresës të sipërcituar të autoritetit kontraktor rezulton se, ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Luar Bros” SHPK dhe e ka njoftuar atë se ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës. Konkretisht, në kthim-përgjigjen e autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka pranuar pretendimet si vijon:

“Me anë të shkresës nr. 1757 prot., datë 22.06.2022, jemi njohur me ankesën tuaj në lidhje me rezultatet e procesit të vlerësimit të ofertave të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-30887-05-26-2022, me objekt: “Blerje kontenierë për mbeturina”, me fond limit 5.146.667 lekë pa TVSH, procedurë nga e cila ju si OE keni bërë ankimin me asyetimin se: Subjektet e tjerë të kualifikuar “N.N.Z.K.Shkodra” SHPK dhe “LEKA-2007” SHPK, nuk përmbushin kriteret e dokumentacionit të tenderit.

Në lidhje me kualifikimin e OE “LEKA-2007” SHPK pretendimet e OE “Luar Bros” SHPK qëndrojnë pasi ky OE është përjashtuar nga prokurimet publike: Operatori ekonomik i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me emër “Leka -2007” shpk, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me NIPT K77929501L, përjashtohet – 24(njëzetekatër) muaj (duke filluar nga data 16.06.2022-16.06.2024).

Ju vemë në dijeni se operatori “N.N.Z.K.Shkodra” SHPK ka paraqitur dokumentacion të plotë dhe të saktë për të dëshmuar plotësimin e ë gjithë kërkesave për kualifikim siç kërkon në DST.

Për sa më sipër ankesa juaj pranohet pjesërisht.

II.10. Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëlidhur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin me Nr. 652/2022 datë 12.07.2022 ku vendosi:

1. *Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-30887-05-26-2022, me objekt: “Blerje kontenierë për mbeturina”, me fond limit 5.146.667 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 13.06.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Sarandë.*
2. *Të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.*
3. *Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.11. Referuar dokumentacionit të dosjes administrative operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumenta pranë komisionit të Prokurimit Publik, në zbatim të nenit 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues si edhe informacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor:

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Luar Bros” SHPK mbi kundërshtim të vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “N.N.Z.K.Shkodra” SHPK: me pretendimin se: *[..ky operator ekonomik nuk përmbush kriterin 2.3.4, se: “Nga komunikimet me prodhues të mallrave objekt prokurimi si edhe nga kërkimet në faqen zyrtare të prodhuesve apo distributorëve të autorizuar, kemi bindjen se ky operator ekonomik, nuk plotëson as specifikimin certifikatë cilësie: **Të jetë cilësore të plotësojë normat e komunitetit evropiane SIPAS NORMATIVËS UNI EN 840 (10571), ...nuk plotëson kriterin për dokumentacion justifikues (certifikata) për standarte si edhe kërkesa e shprehur në specifikim teknike...]*** Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar dokumentacionit të tenderit publikuar në SPE, **në shtojcën 7, Krite të veçanta të kualifikimit, 2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.4 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmeria me standartet e kërkuara operatori ekonomik duhet të paraqese dokumentacion justifikues (çertifikata) për standartet dhe kërkesat që duhet të përmbushin zërat e kërkuara në formularin e specifikimeve teknike.

Gjithashtu në dokumentin e specifikimeve teknike kërkohet:

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

1. Specifikimi i Materialeve: Kontenieret 1100 litra

- Kazani do te jete metalik, mbi rrota (gome te rrotullueshme)
- Kapaku do te jete metalik
- Te kete mbishkrimin : “Bashkia Sarande” dhe viti 2022
- Te kete tape shkarrkimi
- Te kete hapje e mbyllje automatike me pedan kembe
- Muret te jene me spesor 1-3 mm, te rrigjiduara e te galvanizuara
- **Te jete cilesore te plotesoje normat e komunitetit evropiane SIPAS NORMATIVËS UNI EN 840 (UNI 10571).**

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: Malli do të levrohet nga operatori ekonomik që do shpallet fitues i cili duhet të njoftojë 1 ditë përpara për lëvrimin e mallit, ku të përcaktohet sasia, njësia dhe emri i shoqëruesit të mallit. Malli do te dorezohet ne prani te komisionit te marrjes ne dorezim . Ofertuesi fitues do të shoqëroj mallin me këto dokumentacione:

1. Faturen Tatimore e Mallit

2. Çertifikate cilesie ne perputhje me specifikimet teknike

3. Çertifikate origjine

III.1.2. Referuar shyqrtimit të këtij pretendimi të ankimuesit autoriteti kontraktor, në kthimin e përgjigjes lidhur me trajtimin e ankesës është shprehur se:

[...] Ju vemë në dijeni se operatori “N.N.Z.K.Shkodra” SHPK ka paraqitur dokumentacion të plotë dhe të saktë për të dëshmuar plotësimin e ë gjithë kërkesave për kualifikim siç kërkon në DST. [...]

III.1.3. Në nenin 36 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin Publik” përcaktohet se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor."

III.1.4. Referuar nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin Publik" përcaktohet se

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.1.5. Referur nenit 44 “Kërkesat e cilësisë” e VKM 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar citohet:

1. *Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*
2. *Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron punë, furnizime ose shërbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose të tjera, në specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, mund të kërkojë një etiketë specifike si një mënyrë për të vërtetuar se punët, shërbimet ose furnizimet përkojnë me karakteristikat e kërkuara, në përputhje me nenin 37, të LPP-së.*

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

3. *Certifikatat dhe etiketat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, si dhe çdo operator ekonomik duhet të ketë akses në to, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.*
4. *Nëse autoriteti/enti kontraktor kërkon një certifikatë, ose etiketë, ata janë të detyruar të pranojnë çdo certifikatë ose etiketë ekuivalente/ të barasvlershme me të, ose një dokument që provon të njëjtin informacion.*

Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmbushin

III.1.6. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, kriterit kualifikues të përcaktuar në ***shtojcën 7, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”*** në pikën ***2.3.4 “Aftësia Teknike dhe Profesionale”***, Komisioni konstaton, se nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar:

2.3.4 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmeria me standartet e kërkuara operatori ekonomik duhet të paraqese dokumentacion justifikues (certifikata) për standartet dhe kërkesat që duhet të përmbushin zërat e kërkuara në formularin e specifikimeve teknike.

Gjithashtu referuar dokumentit të specifikimeve teknike kërkohet:

1. Specifikimi i Materialeve: Kontenieret 1100 litra

- Kazani do te jete metalik, mbi rrota (gome te rrotullueshme)
- Kapaku do te jete metalik
- Te kete mbishkrimin : “Bashkia Sarande” dhe viti 2022
- Te kete tape shkarrkimi

- Te kete hapje e mbyllje automatike me pedan kembe
- Muret te jene me spesor 1-3 mm, te rrigjduara e te galvanizuara
- **Te jete cilesore te plotesoje normat e komunitetit evropiane SIPAS NORMATIVËS UNI EN 840 (UNI 10571).**

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: Malli do të levrohet nga operatori ekonomik që do shpallet fitues i cili duhet të njoftojë 1 ditë përpara për lëvrimin e mallit, ku të përcaktohet sasia, njësia dhe emri i shoqëruesit të mallit. Malli do te dorezohet ne prani te komisionit te marrjes ne dorezim . Ofertuesi fitues do të shoqëroj mallin me këto dokumentacione:

1. Faturen Tatimore e Mallit
2. Çertifikate cilesie ne perputhje me specifikimet teknike
3. Çertifikate origjine

III.1.7. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “N.N.Z.K.Shkodra” SHPK në fazën e dorëzimit të ofertave të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, nuk ka dorëzuar çertifikatën për plotësimin e Normave të Komunitetit Europian sipas Normativës UNI EN 840 (10571).

III.1.8. Sa më sipër, KPP gjykon se operatori ekonomik “N.N.Z.K.Shkodra” SHPK me dokumentacionin e dorëzuar ne Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE) nuk provon se disponom dokumentacionin justifikues (çertifikatën) *UNI EN 840 (UNI 10571)*, referuar kriterit kualifikues të përcaktuar në *shtojcën 7, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”* në pikën **2.3.4 “Aftësia Teknike dhe Profesionale”** të dokumenteve të tenderit dhe *“specifikimeve teknike”*, është kërkuar [...] ***Te jete cilesore te plotesoje normat e komunitetit evropiane SIPAS NORMATIVËS UNI EN 840 (UNI 10571) [...].*** Autoriteti kontraktor ka përcaktuar në mënyrë të qartë, që ofertuesit për përmbushjen e këtij kriteri kualifikues duhet të paraqesin dokumentacion justifikues (çertifikata) për standartet dhe kërkesat që duhet të përmbushin zërat e kërkuara në formularin e specifikimeve teknike. Në interpretim literal të kriterit KPP gjykon, se autoriteti kontraktor ka kërkuar dokumentacion justifikues (çertifikatë). Ndërsa operatori ekonomik “N.N.Z.K.Shkodra” SHPK referuar dokumentacionin të paraqitur në (SPE), nuk ka përmbushur kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor duke mos provuar se disponon çertifikatën *SIPAS NORMATIVËS UNI EN 840 (UNI 10571)*, të kërkuar në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi lidhur me dorëzimin e dokumentacionit justifikues (çertifikatës) në momentin e hapjes dhe dorëzimit te ofertave.

III.1.9. Komisioni gjykon, se vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kritereve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që

nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “N.N.Z.K.Shkodra” SHPK nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Luar Bros” SHPK qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Luar Bros” SHPK mbi kualifikimin e shoqërisë “N.N.Z.K.Shkodra” SHPK., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi administrative, pasi referuar gjykimin më sipër gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “N.N.Z.K.Shkodra” SHPK do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht duke përmbushur interesin e ankimuesit.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë votash,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Luar Bros” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-30887-05-26-2022, me objekt: “Blerje kontenierë për mbeturina”, me fond limit 5.146.667 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 13.06.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Sarandë.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “N.N.Z.K.Shkodra” SHPK, dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.

4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Luar Bros” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri